



## AGJENDA E TRAJNIMIT

Për Hyrjen në Profesion – Kontabilist i Miratuar

**Tema:** Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

**Kohëzgjatja:** 32 orë

**Periudha:** 24 Prill – 03 Maj 2026

**Organizimi:** Auditor

**Grupi:** Kandidatë për KM

### Objektivi i Trajnimit

Ky trajnim përbën komponentin teorik të Hyrjes në Profesion (IPD – Initial Professional Development), sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (IES 2–6) të IFAC-ut dhe në përputhje me Ligjin Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar. Ai synon të përgatitë kandidatët me njohuritë teknike të nevojshme për ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar.

- Të zhvillojë kompetencën teknike në zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 1–15) në përgatitjen e pasqyrave financiare për njësi ekonomike të të gjitha kategorive.
- Të sigurojë njohjen e kuadrit ligjor e rregullator që rrethon profesionin e Kontabilistit të Miratuar, duke përfshirë Ligjin Nr. 10091/2009, Ligjin Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.
- Të përgatitë kandidatët për kalimin me sukses të provimit të aftësive profesionale për KM, si kusht për marrjen e titullit Kontabilist i Miratuar.

### Rezultatet e Pritshme

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë dhe zbatojnë kuadrin konceptual të SKK-ve për njohjen, matjen dhe paraqitjen e elementeve të pasqyrave financiare.
- Të aplikojnë trajtimin kontabël për aktivet afatgjata materiale e jomateriale, inventarët, instrumentet financiare, dhe aktivet biologjike në përputhje me SKK-të përkatëse.
- Përgatisin pasqyra financiare të plota sipas SKK 2, duke përfshirë shënimet shpjeguese.
- Aplikojnë trajtimin kontabël të të ardhurave, provizioneve, qerave, granteve, tatimit mbi fitimin, dhe efekteve të kursit të këmbimit.
- Kontabilizojnë investimet në pjesëmarrje, sipërmarrjet e përbashkëta dhe kombinimet e bizneseve.
- Njohin kërkesat specifike të kontabilitetit për mikronjositë dhe organizatat jofitimprurëse.

### Programi i Detajuar

Orari	Moduli	Lektori
<b>E Premte, 24 Prill 2026</b>		
17:00 – 21:00	Kuadri për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare – <b>SKK 1</b> Kontabiliteti i Mikronjësive – <b>SKK 15</b> <b>SKK për OJF</b>	<i>Prof. Dr. Sotiraq Dhamo</i>
<b>E Shtunë, 25 Prill 2026</b>		
14:00 – 17:00	Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale – <b>SKK 5</b>	<i>Dr. Nertila Çika</i>



Orari	Moduli	Lektori
17:00 – 19:00	Aktivitet Biologjike – <b>SKK 13</b>	<i>Dr. Nertila Çika</i>
<b>E Diel, 26 Prill 2026</b>		
09:00 – 11:00	Instrumentet financiare – <b>SKK 3</b>	<i>Dr. Elira Hoxha</i>
11:00 – 15:00	Grantet dhe format e ndihmës – <b>SKK 10</b> Kombinimi i bizneseve – <b>SKK 9</b>	<i>Dr. Julian Naqellari</i>
<b>E Premte, 01 Maj 2026</b>		
17:00 – 21:00	Provizionet, pasivet, aktivet e kushtëzuara – <b>SKK 6</b> Kontabilizimi i qerave – <b>SKK 7</b>	<i>Prof. Dr. Sotiraq Dhamo</i>
<b>E Shtunë, 02 Maj 2026</b>		
12:00 – 15:00	Përgatitja & Paraqitja e Pasqyrave Financiare – <b>SKK 2</b>	<i>Dr. Elira Hoxha</i>
15:00 – 17:00	Inventarët – <b>SKK 4</b>	<i>Prof. Dr. Ingrid Shuli</i>
17:00 – 19:00	Tatimi mbi fitimin – <b>SKK 11</b>	<i>Msc. Indrit Ago</i>
<b>E Diel, 03 Maj 2026</b>		
09:00 – 10:00	Efektet e kursit të Këmbimit – <b>SKK 12</b>	<i>Dr. Julian Naqellari</i>
10:00 – 12:00	Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta – <b>SKK 14</b>	<i>Dr. Julian Naqellari</i>
12:00 – 15:00	Të ardhurat – <b>SKK 8</b>	<i>Msc. Indrit Ago</i>
<b>TOTALI:</b>	<b>32 orë trajnimi · 6 ditë · 12 seanca · 5 lektorë</b>	

## Shënime

- Frekuentimi i plotë i trajnimit është i detyrueshëm për pranimin në provimin e aftësive profesionale.
- Trajnimi i Hyrjes në Profesion realizohet në kuadër të kërkesave të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, kërkesave statutoire të IKM, si dhe IES 2 (Kompetenca Teknike) të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Edukimit të IFAC-ut.
- Për çdo pyetje apo sqarim, ju lutem kontaktoni IKM-në në adresën: [ikm.alb@gmail.com](mailto:ikm.alb@gmail.com)